

HIGHTEL TOWERS

ALBANIA Sh.p.k

**Pasqyrat Financiare
për vitin që mbyllet
më 31 Dhjetor 2016**

Contents

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARAVE	6
1. SHOQËRIA RAPORTUESE	5
2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL	5
2.1 BAZAT E PËRGATITJES	5
2.2 BAZAT E MATJES.....	5
2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES	5
2.4 PLOITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL.....	5
3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE PROFESIONALE.....	7
4. AKTIVET AFATGJATA.....	7
5. TË DREJTA TË ARKËTUESHME	8
6. MJETE MONETEARE	8
7. SHPENZIME TË SHTYRA.....	8
8. KAPITALI AKSIONAR	8
9. DETYRIME AFATGJATA.....	9
10. DETYRIMET AFATSHKURTRA.....	9
11. TË ARDHURAT.....	9
12. KOSTO E PUNËS	9
13. SHPENZIME TË TJERA	10
14. TË ARDHURA FINANCIARE.....	10
15. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA	10
16. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT	11

(Vlerat janë në ALL)

më 31 Dhjetor 2016

Shënimet nga 1-15 që shoqërojnë këto pasqyra financiare janë pjesë përbërëse e tyre.

Pasqyrat financiare të Hightel Towers Albania u miratuan nga drejtimi më 31.01.2017 dhe u firmosën nga:

NUIS: £ 42

Hartues i pasqyrave financiare

i pasqyrave financiare

Jon Consultancy
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14, H. 6, An. 27
Tiranë, Shqipëri
VIBS-KT140400711

3

PASQYRA E PERFORMANCËS

Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2016

	Shënimi	31/12/2016	31/12/2015
Të ardhurat	11	5,700,244	
Të ardhura të tjera		627,000	
Totali i të ardhurave		6,327,244	-
Kosto e punës	12	(4,285,356)	(98,774)
Shpenzime të tjera	13	(5,122,124)	(24,516)
Humbje operative		(9,407,480)	(123,290)
Të ardhura nga kurset e kembimit	14	3,353,368	159,829
Të ardhura financiare neto		3,353,368	159,829
Fitimi/(humbja) para tatimit		273,132	36,539
Shpenzimi për tatim fitimin			
Fitimi i periudhës		273,132	36,539
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse		273,132	36,539

Shënimet nga 1-15 që shoqërojnë këto pasqyra financiare janë pjese përbërëse e tyre.



HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.
(Vlerat janë në ALL)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Rezerva	Fitimi / (humbja) e vitit	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	100,000		(5,243,879)	(5,143,879)
				-
Fitimi/(humbja) e vitit			36,537	36,537
Dividendë				-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2015	100,000	-	(5,207,342)	(5,107,342)
Emetim i kapitalit nga aksionerët	204,740,311			204,740,311
Fitimi/(humbja) e vitit			273,132	273,132
Shpërndarja e fondeve				-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2016	204,840,311	-	(4,934,210)	199,906,101

Shënimet nga 1-15 që shoqërojnë këto pasqyra financiare janë pjese përbërëse e tyre.



PASQYRA E FLUKSEVE TË PARAVE

Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2016

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) para tatimit	273,132	36,539
<i>Rregullimet per:</i>		
Amortizim	38,234	
Fitime/humbje nga kurset e kembimit		
Fitim nga shitja e Toka, Ndertesa, Makinerite		
Zhvleresim i te arketueshmeve	141,432	(284,170)
Rritje/(renie) e detyrimeve	1,225,080,565	611
Cash i gjeneruar nga operacionet perpara ndryshimit ne kapital	1,225,533,363	(247,020)
Fluksi i parave nga aktiviteti i investimeve		
Blerje aktive afatgjat	(208,525)	
Shpenzime te shytyra	(21,992,658)	
Parapagime per investim ne njesi ekonomike	(1,544,601,988)	(98,256,000)
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet investuese	(1,566,803,171)	(98,256,000)
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Fonde te marra nga investitorët	128,112,568	98,049,540
Pagesa e huave	12,281,994	
Emetim i kapitalit aksioner	204,740,311	
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare	345,134,873	98,049,540
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	3,865,065	506,134
Mjetet monetare ne 1 Janar	506,134	
Mjetet monetare ne 31 Dhjetor	4,371,199	506,134

Shënimet nga 1-15 që shoqërojnë këto pasqyra financiare janë pjese përbërëse e tyre.

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare

(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

1. SHOQËRIA RAPORTUESE

Hightel Towers Albania Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar dhe ushtron aktivitetin sipas legjislacionit shqiptar. Hightel Towers Albania është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NUIS L42222001F në tetor 2014. Adresa e shoqërisë është Rr Sami Frasheri, Kompleksi Nobis, Tiranë, Shqipëri.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është në fushën e telekomunikacionit (Projektimin, ndertimin dhe/ose menaxhimin e rrjeteve dhe infrastrukturave për komunikimet elektronike fikse, mobile dhe satelitore; ofrimi i shërbimeve dhe sistemeve gardian për operatorët e komunikimeve elektronike (Wireless, Wi-Max, Wi-Fi, WISP, TV Mobile, WLL, Paging).

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është z. Artan Xhori. Numri i punëmarrësve më 31 dhjetor 2016 është 2.

Më 31 dhjetor 2016 shoqëria është pronare e vetme e shoqërisë Plus Network sh.p.k.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Këto pasqyrave financiare janë hartuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë.

2.2 BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazat e kostos historike.

2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në monedhën Lekë (ALL), e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.4 PLOITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar vazhdimisht nga shoqëria, nëse nuk shprehet ndryshe.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë janë si në vijim:

	31/12/2016	31/12/2015
Lekë / EUR	135.23	137.28
Lekë / USD	128.17	125.79

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i njeh të arkëtueshmet dhe mjetet monetare në datën e transaksionit. Të gjitha aktivitet e tjera financiare njihen fillimisht në datën në të cilën shoqëria bëhet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria ç'registron mjetet financiare kur (a) aktivitet janë shpenguar apo të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitet ndryshe skadojnë ose (b) Shoqëria ka

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare

(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje me kualifikim ndërsa (i) të transferojë kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë apo (ii) as transferimin e as ruajtjen e rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia por duke mos mbajtur kontrollin.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur pa nevojë të imponojnë kufizime shtesë në shitje.

Shoqëria ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme fillimisht fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke i zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Cash dhe ekuivalentët e cashit

Cash dhe ekuivalentët e cashit përbëjnë gjëndjen e cashit në bankë dhe arkë.

Të pagueshme tregëtare dhe të pagueshme të tjera

Të pagueshme tregëtare dhe të pagueshme të tjera janë paraqitur me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv.

(c) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që është e zhvlerësuar. Një aktiv financiar është i zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim negativ në flukset monetare të ardhshme të këtij aktiviteti që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në fitim ose humbje.

(d) Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) Aktivet jo financiare

Në çdo datë raportuese, shoqëria rishikon vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëqoftë se ka evidencë për zhvlerësim atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë pakësuar me koston e shitjes së tij.

Vlera në përdorim bazohet në flukset e ardhshme të çmuara, skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëqoftë se vlera kontabël e një aktiviteti e kalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë:

Kategoritë	%
Ndërtesa	3%
Mjete motorike	20%
Pajisje kompjuterike dhe zyre	20-25%

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.**Shënime të pasqyrave financiare***(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***(e) Përfitimet e punëmarrësve***Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Pagat, rogat, kontributet në fondet shtetërore ose private të pensioneve dhe sigurimeve shoqërore, lejet e pagueshme vjetore dhe pushim mjekësor, shpërblime, dhe përfitimet jo-monetare janë përllogaritur në vitin në të cilin shërbimet e lidhura janë dhënë nga punonjësit e Shoqërisë. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të bërë pagesat e pensioneve apo të përfitimeve të ngjashme përtej pagesave për skemën ligjore me kontribute të përcaktuara.

(f) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, shoqëria ka detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe se është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkojë për të shlyer detyrimin. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

(g) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ashtu sikurse edhe të ardhurat apo shpenzimet nga interesat janë pasqyruar neto.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE PROFESIONALE

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe të faktorëve të tjerë, duke përfshirë këtu pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme për rrethanat ku ndodhin.

4. AKTIVET AFATGJATA

	Tokë	Ndërtesa	Paisje zyre	Paisje Informatike	Totali
<u>Kosto</u>					
Më 1 Janar 2015	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2015	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	150,000	58,525	208,525
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	-	-	150,000	58,525	208,525
<u>Zhvlerësim i akumuluar</u>					
Më 1 Janar 2015	-	-	-	-	-
Shpenzime të vitit	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2015	-	-	-	-	-
Shpenzime të vitit	-	-	25,000	13,234	38,234
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	-	-	25,000	13,234	38,234
<u>Vlera kontabël neto</u>					
Më 31 Dhjetor 2015	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	-	-	125,000	45,291	170,291

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.**Shënime të pasqyrave financiare***(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***5. TË DREJTA TË ARKËTUESHME**

Të drejta të arkëtueshme paraqiten si më poshtë:

	31/12/2016	31/12/2015
TVSH e kreditueshme	592,420	976,343
Parapagime të dhëna	94,661	284,170
Të drejta ndaj klientëve	432,000	
	1,119,081	1,260,513

6. MJETE MONETEARE

Cashi dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2016 janë Lek 4,371,199 (2015: Lek 506,134).

	31/12/2016	31/12/2015
Banka	4,348,038	506,134
-në ALL	19,120	
- në valut në	4,328,918	506,134
Arka	23,161	
	4,371,199	506,134

7. SHPENZIME TË SHTYRA

Shpenzime të shtyra në datë 31.12.2016 përbëjnë

	31/12/2016	31/12/2015
Siguracion pasurie	2,490,033	
Shpenzimie juridike në lidhje me përfitimin e financimit nga BSTDB	19,502,625	-
	21,992,658	-

Siguracioni i pasurisë përfshin periudhën 25.11.2016 deri më 25.11.2017. Periudha nga 25.11.2016 deri në fund të vitit është shpenzim i periudhës aktuale kurse pjesa tjetër i takon periudhës pasardhëse (2017).

Shpenzimet juridike në lidhje me përfitimin e financimit nga BSTDB do të amortizohen në periudhat pasardhëse sipas amortizimit të financimit që do të përfitohet.

8. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i nënshkruar përbëhet nga 100 pjesë me vlerë nominale 2.048.403,11 lekë secila.

Më 31 Dhjetor 2016		
	%	Vlera në lekë
HIGHTEL TOWER SPA	74.00%	151,581,830
SAMIR MANE	8.32%	17,042,714
TV KLAN	4.42%	9,053,942
TOP CHANNEL	4.42%	9,053,942
UNI-COM	4.42%	9,053,942
ARTAN XHORI	4.42%	9,053,942
	100.00%	204,840,311

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.**Shënime të pasqyrave financiare***(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***9. DETYRIME AFATGJATA**

Detyrimet ndaj huadhënësve dhe bankave paraqiten si më poshtë:

<i>in ALL</i>	31/12/2016	31/12/2015
Kontribute të aksionerëve dhe investitorëve	249,985,908	91,977,600
Hua nga të tretë	12,281,994	29,895,740
	262,267,902	121,873,340

<i>in EUR</i>	31/12/2016	31/12/2015
Kontribute të aksionerëve dhe investitorëve	1,848,598	670,000
Hua nga të tretë	90,823	217,772
	1,939,421	887,772

10. DETYRIMET AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra përbëhen nga:

	31/12/2016	31/12/2015
Të pagueshme ndaj furnitorëve	1,224,926,447	
Të pagueshme ndaj punëmarrësve	27,528	
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	45,778	
Tatimi i mbajtur në burim	43,130	
Të Pgueshme të tjera		2,511
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	46,331	6,138
	1,225,089,214	8,649

Të pagueshme ndaj furnitorëve perfaqësojnë faturat e pa likujduara ndaj PLUS COMMUNICATION, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA dhe të tjerë.

11. TË ARDHURAT

Të ardhurat paraqiten si më poshtë:

	31/12/2016	31/12/2015
Të ardhurat	5,700,244	
Të ardhura të tjera	627,000	
	6,327,244	-

12. KOSTO E PUNËS

Kosto e punës paraqitet si më poshtë:

	31/12/2016	31/12/2015
Pagat e punëmarrësve	3,897,650	
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	387,706	73,656
	4,285,356	73,656

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.**Shënime të pasqyrave financiare***(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***13. SHPENZIME TË TJERA**

Shpenzime të tjera paraqiten si më poshtë:

	31/12/2016	31/12/2015
Shpenzime amortizimi	38,234	
Komisione bankare	199,294	24,516
Energji elektrike	9,273	
Shpenzime telefonie	4,500	
Shpenzime financiare	1,529,800	
Shpenzime juridike	1,638,122	
Qira zyresh	579,225	
Qira stacionere	397,600	
Mirëmbajtje dhe riparime	90,353	
Siguracion pasurie	226,367	
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	
Taksa pullash noteriale	14,400	
Gjoha dhe dëmshpërblime	10,359	
Humbje nga mosarketimet	276,060	
Shpenzime të tjera operative	41,537	
	5,122,124	24,516

14. TË ARDHURA FINANCIARE

Të ardhurat financiare pasqyrojnë fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit dhe paraqiten si më poshtë:

	31/12/2016	31/12/2015
Fitime nga kurset e këmbimit	3,411,206	159,829
Humbje nga kurset e këmbimit	57,838	
	3,353,368	159,829

15. SHPENZIME PËR TATIM FITIMIN

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime për tatim fitimin për vitin 2016 dhe për vitin 2015. Shoqëria nuk parapagoi tatim fitim gjatë vitit 2016.

16. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET RASTËSORE

Shoqëria nuk është përfshirë në ndonjë proces ligjor, ndonjë pretendimi apo ndonjë kontestimi gjatë rrjedhës normale të aktivitetit.

17. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm apo kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

HIGHTEL TOWERS ALBANIA sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare

(Vlerat janë në ALL, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shoqëria ka marrëdhënie të lidhura me aksionarët e saj dhe investitorë si më poshtë:

- Hightel Towers SPA – Shoqëria mëmë
- Samir Mane - Aksioner
- TV Klan sh.a. – Aksioner
- Top-Channel sh.a. – Aksioner
- UNI-COM – Aksioner
- Artan Xhori – Aksioner & Administrator
- PLUS NETWORK – Shoqëri e kontrolluar

Hua nga PLUS NETWORK shpk ne shumën 90,823 Euro ekuivalent në lekë 12,281,994 lekë.

Kontribute të aksionerëve dhe investitorëve janë si më poshtë:

	Në Euro	Në Lekë
HTI SPA	1,367,400 €	184,913,502
SAMIR MANE	154,778 €	20,930,629
TV KLAN	81,606 €	11,035,579
TOP- CHANNEL	81,602 €	11,035,038
UNI-COM	81,606 €	11,035,579
ARTAN XHORI	81,606 €	11,035,579
	1,848,598 €	249,985,908

18. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Drejtimi i shoqërisë nuk ka dijeni për ndonjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkon rregullime apo shënime shpjeguese të tjera për pasqyrat financiare.

